

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Athina mohon kërcënimin e ambasadores amerikane për rrëzimin e qeverisë greke
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/athina-mohon-kercenimin-e-ambasadores-amerikane-per-rr-ezimin-e-qeverise-g-i589048
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHÀ


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 19:33:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 19:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	27f9d4f26c581b6ccf074619cde5b36729e7f542cffa8ed3bc45e772ec311490
TEKSTI	a284e502fa7d12b58ec8d8780f267e8d3f1385f8c788e4e9c3d4bdfb3229178
PAMJA	de024804e757faf95ec1c331dfc1575fa842887e8707f5cac559bbe515cc69be

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a5e63b4952ea48f17213cb1ebbd62782b8b6db9ef853f302917102264760606e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	6a4afcd2fdbaaf1fd2c3f5e26c1cb3946785567999c2c435268418bbbf9bbb6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a5e63b4952ea48f17213cb1ebbd62782b8b6db9ef853f302917102264760606e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

ie [Athina mohon kercenimin e ambasadores amerikane per rrezimin e qeverise greke](#)Prishtine/ 'Jo ne emrin tim', vijon per te 13-en nate protesta kundervendimit denues f
fundit

Athina mohon kërcënimin e ambasadores amerikane për rrëzimin e qeverisë greke



28 Shtator 2026, 21:30Rajoni TEMA



Qeveria greke ka mohuar raportimin e "Wall Street Journal" se ambasadorja e SHBA-së në Athinë, Kimberly Guilfoyle, ka kërcënuar me rrëzimin e qeverisë greke gjatë një darke me zyrtarë grekë dhe amerikanë.

Zëdhënësi i qeverisë greke, Pavlos Marinakis, tha se nuk është ngritur kurrë çështja e një kërcënimi ndaj qeverisë dhe se një veprim i tillë nuk do të tolerohej.

"Duhet të them dhe ta bëj të qartë se nuk ka pasur kurrë asnjë çështje që lidhet me një kërcënim ndaj qeverisë greke dhe, për të qenë seriozë, një gjë e tillë nuk do të tolerohej kurrë", deklaroi Marinakis.

Sipas "Wall Street Journal", incidenti i pretenduar ka ndodhur gjatë një darke në Athinë në muajin mars, ku Guilfoyle është përfshirë në një debat me ministrin grek të Energjisë, Stavros Papastavrou.

Sipas burimeve të cituara nga gazeta amerikane, gjatë bisedës për rënien e qeverisë së Rumanisë, ambasadorja amerikane dysohet të ketë thënë: "Ne mund ta bëjmë këtë me çdo vend që duam. Mund ta bëjmë edhe këtu".

Papastavrou, sipas të njëjtit raportim, i është përgjigjur se Shtetet e Bashkuara nuk mund ta zëvendësonin qeverinë greke, e cila është zgjedhur nga qytetarët.

Avokati i Kimberly Guilfoyle ka kundërshtuar përshkrimin e bisedës të publikuar nga "Wall Street Journal". Ndërkohë, edhe qeveria greke ka mohuar se ka pasur ndonjë kërcënim ndaj saj.

Deklaratat e Marinakis erdhën në një kohë kur raportimi ka shkaktuar reagime edhe nga partitë opozitare greke, të cilat kanë kërkuar sqarime lidhur me takimin dhe pretendimet e publikuara.

Përveç çështjes politike, artikulli i "Wall Street Journal" lidhet edhe me përpjekjet e Guilfoyle për promovimin e gazit natyror të lëngshëm amerikan në Ballkan dhe rolin e Greqisë në transportimin e gazit amerikan drejt vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Marinakis hodhi poshtë gjithashtu pretendimet për ekzistencën e ndonjë "shantazhi politik" lidhur me gazin amerikan, duke theksuar se marrëdhëniet mes Greqisë dhe SHBA-së janë strategjike dhe bazohen, sipas tij, në respektin e ndërsjellë dhe vlerat e përbashkëta.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Prishtinë/ 'Jo në emrin tim', vijon për të 13-ën natë protesta kundërvendimit dënues të Gjykatës Speciale](#)

21:20 Rajoni

Pas bisedës Vuçiç-Putin, Departamenti i Shtetit rikujton deklaratën e Rubios: Serbia, e përfshirë në çështje problematike

20:40 Rajoni

Partitë në Kosovë ende pa marrëveshje për presidentin e ri, ndërsa afati po shkon drejt fundit

18:30 Rajoni / 2 komente

“Specialja kriminalizoi procesin”, analisti: Pa ikur Kurti nga pushteti, beteja në Hagë është e humbur

18:10 Rajoni · 8 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.